



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.12

2004

12 mars

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9180 datë 5.2.2004	Për statistikat zyrtare.....	489
Ligj nr.9181 datë 5.2.2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve", ndryshuar me ligjin nr.8393, datë 20.9.1998.....	497
Ligj nr.9182 datë 5.2.2004	Për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.....	500
Ligj nr.9183 datë 5.2.2004	Për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.....	505

L I G J
Nr.9180, datë 5.2.2004

PËR STATISTIKAT ZYRTARE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij ligji është rregullimi i mënyrës së marrjes, organizimit, nxjerrjes dhe shpërndarjes së statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Përkufizime dhe shkurtime

Për qëllim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "statistika" janë të dhëna të përftuara nga përpunimi i të dhënave, për të karakterizuar fenomene kolektive në një popullim të dhënë;
- b) "statistika zyrtare" është informacion sasior dhe përfaqësues për situatën ekonomike, demografike, sociale dhe mjedisore në Shqipëri, i prodhuar nga ose nën autoritetin e INSTAT-it, në kuadrin e programit të statistikave zyrtare;
- c) "statistika administrative" janë statistika të tjera, të ndryshme nga statistikatat zyrtare, të prodhuara nga organet dhe agjencitë publike;
- ç) "programi i statistikave zyrtare" është programi i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;
- d) "popullatë" është bashkësi e njësive statistikore, pa dallim nëse janë persona fizikë e juridikë, familje ose çdo lloj njësie ekonomike;
- dh) "nxjerrje e statistikave" janë të gjitha veprimtaritë e nevojshme për përgatitjen, mbledhjen, ruajtjen, përpunimin, përmbledhjen, analizimin, interpretimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore;
- e) "shpërndarja" është sigurimi për përdoruesit, pavarësisht nga forma dhe mjetet e përdorura, të të dhënave statistikore, por duke mënjanuar zbulimin e të dhënave konfidenciale;
- ë) "njësi statistikore" është institucion ose person fizik, juridik dhe familje që, sipas këtij ligji, është i detyruar të japë të dhëna statistikore për agjencitë statistikore të autorizuar;
- f) "agjenci statistikore" është autoriteti, përveç Institutit të Statistikave, i autorizuar, sipas programit të statistikave zyrtare, për të ndërmarrë veprimtari për nxjerrjen e statistikave zyrtare;
- g) "veprimtari tjetër statistikore" është veprimtaria statistikore që nuk është përfshirë në programin e statistikave zyrtare;
- gj) "të dhëna konfidenciale" janë të dhëna të marra nga një agjenci statistikore, të cilat lejojnë identifikimin e njësive statistikore, duke zbuluar kështu të dhëna individuale;
- h) "vrojtim statistikor" është mbledhja e të dhënave nga njësitë statistikore, duke u kërkuar të dhëna për vete ose për veprimtaritë e tyre, që do të përdoren vetëm për nxjerrjen e statistikave;
- i) "regjistrim i përgjithshëm" është vrojtimi i çdo njësie ekonomike ose familjare në Republikën e Shqipërisë, të cilat janë të detyruara të përgjigjen;
- j) "ministri" është anëtar i Këshillit të Ministrave, i ngarkuar për ndjekjen e veprimtarisë së INSTAT-it.

2. Në këtë ligj:

- a) “INSTAT-i” është Instituti i Statistikave;
- b) “programi” nënkupton programin e statistikave zyrtare.

Neni 3

Regjistrimet e përgjithshme

Çdo regjistrim i përgjithshëm përfshihet në program, por realizimi i një regjistrimi të tillë rregullohet me ligj të veçantë.

Neni 4

Parimet e statistikave zyrtare

Për të siguruar cilësinë e statistikave zyrtare dhe për të ruajtur besimin e publikut në to, organizimi dhe zbatimi i programit udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

a) “paanshmëria”, që nënkupton mënyrën objektive dhe të pavarur të prodhimit të statistikave, të lira nga çdo presion politik ose i grupeve të tjera të interesuara, veçanërisht lidhur me përzgjedhjen e teknikave, përkufizimeve dhe metodologjisë më të mirë të përshtatshme për të arritur objektivat e vendosur. Ajo nënkupton disponueshmërinë e statistikave me një vonesë sa më të vogël për të gjithë përdoruesit;

b) “besueshmëria”, që është karakteristikë e statistikave për të reflektuar sa më të besueshëm që të jetë e mundur realitetin, të cilin ato janë parashikuar të përfaqësojnë. Ajo nënkupton përdorimin e kriterëve shkencorë për zgjedhjen e burimeve, metodave dhe procedurave;

c) “pavarësia profesionale”, që personelit të INSTAT-it ose të agjencive statistikore, gjatë zbatimit të programit, nuk i lejohet të kërkojë ose të marrë udhëzime nga Qeveria, autoritetet e tjera shtetërore, partitë politike ose çfarëdo lloj grupi tjetër i interesuar, veçanërisht në përzgjedhjen e burimeve të të dhënave, metodave dhe procedurave statistikore, në përmbajtjen, formën dhe kohën e shpërndarjes, si dhe në zbatimin e konfidencialitetit statistikor;

ç) “përkatësia”, që është mbledhja e të dhënave që kufizohet në atë çfarë është e nevojshme për arritjen e rezulttit të kërkuar;

d) “kosto-efektiviteti”, që është përdorimi më i mirë i mundshëm i të gjitha burimeve të disponueshme dhe kufizimi i barrës së atyre që përgjigjen. Puna dhe kostoja që kërkon prodhimi i statistikave duhet të jenë në përpjesëtim me rëndësinë e rezulttit të kërkuar;

dh) “konfidencialiteti statistikor”, që është mbrojtja e të dhënave që lidhen me njësi statistikore të veçanta, të cilat janë marrë direkt për qëllime statistikore ose indirekt nga burime administrative ose të tjera kundër çdo shkeljeje të së drejtës së konfidencialitetit. Ajo nënkupton parandalimin e përdorimit jostatistikor të të dhënave të marra dhe zbulimin e paligjshëm;

e) “transparenca”, që është e drejta e atyre që përgjigjen të kenë informacion mbi bazën ligjore, qëllimin për të cilin janë kërkuar të dhënat dhe masat mbrojtëse të marra.

Neni 5

Publikimi i të dhënave statistikore zyrtare

1. Statistikat zyrtare sigurojnë të dhëna sasiore dhe përfaqësuese për publikun e gjerë, Kuvendin, Këshillin e Ministrave, institucione të tjera publike, organizata ekonomike, të biznesit dhe ato shoqërore, për institucionet kërkimore dhe akademike, median, si në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Ato ta reflektojnë gjendjen realisht dhe të shpërndajnë rezultate në mënyrë të paanshme.

2. Të dhënat e nevojshme për të vlerësuar cilësinë e statistikave zyrtare, në veçanti të dhënat për metodat e përdorura për nxjerrjen e statistikave dhe për parimet e zbatuara, janë të disponueshme për publikun.

3. Autoritetet shtetërore dhe grupet e tjera të përmendura në shkronjën “c” të nenit 4 duhet të respektojnë parimet e përshkruara në nenin 4 dhe në këtë nen dhe nuk u lejohet të ndikojnë mbi personelin e agjencive statistikore në kryerjen e detyrave të tyre.

Neni 6

Programi i statistikave zyrtare

1. Programi mbulon të dhënat statistikore, të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, duke u përqendruar në fenomene thelbësore për vendimmarrësit, si dhe duke respektuar të drejtën e qytetarëve për të dhëna zyrtare. Për realizimin e programit mbahen parasysh si marrëdhëniet ndërmjet kostove e problemeve që dalin dhe të përfitimeve.

2. Kuvendi miraton programin e statistikave zyrtare, i cili mbulon periudhën e pesë viteve kalendarike. Programi botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Programi përfshin të paktën:

- a) përshkrimin e statistikave kryesore dhe treguesit që vihen në dispozicion;
- b) institucionet përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e rezultateve;
- c) klasifikimet që përdoren;
- ç) nivelin në të cilin statistikave dhe treguesit bëhen të disponueshëm (nivel kombëtar, prefekturë, rrethi dhe kështu me radhë);
- d) frekuencën me të cilën statistikave dhe treguesit bëhen të disponueshëm;
- dh) vitin në të cilin do të shpërndahen statistikave dhe treguesit;
- e) vitin në të cilin do të bëhen për herë të parë të disponueshme statistikave dhe treguesit e rinj;

ë) listën e burimeve të përdorura për nxjerrjen e statistikave dhe të treguesve, të cilat mund të jenë të dhëna administrative ose vrojtme;

f) burimet administrative, domethënë regjistrat, regjistrimet, të dhënat dhe rezultatet që duhet t'i kalojnë INSTAT-it dhe agjencive statistikore, institucionet përgjegjëse për këto veprimtari, si dhe kufijtë kohorë për këto veprimtari;

g) listën e vrojtmeve që duhet të ndërmerren nga institucionet përgjegjëse për projektimin dhe drejtimin e tyre, pyetësorët e plotësuar, regjistrimet e të dhënave dhe rezultatet që duhet t'i kalojnë INSTAT-it dhe agjencive statistikore, si dhe kufijtë kohorë për këto veprimtari.

Neni 7

Përgjegjësia e INSTAT-it

INSTAT-i është përgjegjës:

- a) për t'i propozuar Këshillit të Statistikave programin;
- b) për të siguruar zbatimin e programit të miratuar;
- c) për të siguruar se statistikave në program janë:
 - i) të besueshme;
 - ii) të paanshme;
 - iii) objektive;
- ç) për të siguruar se të dhënat e kërkuara për programin janë mbledhur, përpunuar, shpërndarë dhe depozituar, duke përdorur praktikën më të mirë profesionale, përfshirë parimet shkencore dhe etiket profesionale;
- d) për të dhënë ndihmën profesionale në interpretimin e drejtë të të dhënave në statistikave zyrtare;
- dh) për të nxitur rolin dhe kuptimin e statistikave në Shqipëri;
- e) për të siguruar se statistikave zyrtare janë bërë të disponueshme në baza paanësie për të gjithë përdoruesit e interesuar;
- ë) për të vendosur në statistikave zyrtare të gjitha përkufizimet statistikore, klasifikimet dhe nomenklaturat, në përputhje me konceptet dhe klasifikimet ndërkombëtare, aty ku është e mundur;

f) për të përditësuar të dhënat për të gjitha marrëdhëniet e agjencive statistikore shqiptare me agjencitë ndërkombëtare, për çështjet që kanë lidhje me statistikën zyrtare shqiptare, të ditës ose në perspektivë dhe për të udhëhequr përfaqësimin statistikor shqiptar në ato marrëdhënie kur kërkohet dhe në rastet ku implikimet ndikojnë një sërë agjencish statistikore shqiptare;

g) për të krijuar, mirëmbajtur dhe përditësuar çdo regjistër statistikor.

Neni 8

Detyrat dhe të drejtat e INSTAT-it

1. Në vijim të përgjegjësisë, sipas shkronjave “c” dhe “ç” të nenit 7 të këtij ligji, INSTAT-i duhet:

a) të nxjerrë e të bëjë publike e funksionale, për të gjitha agjencitë statistikore, udhëzimet për standardet profesionale në nxjerrjen e statistikave zyrtare;

b) të shqyrtojë procedurat për nxjerrjen e statistikave, të përshtatura nga çdo agjenci statistikore dhe nga çdo institucion qendror ose vendor;

c) të japë që në fillim miratimin për çdo vërtetim statistikor. Kriteret për miratim do të jenë:

i) vërtetimi;

ii) shmangia, nëse nuk përfshihet në program, e çdo dublikimi me ose pa efekt të kundërt me programin;

iii) rezultatet e analizuara dhe të shpërndara, sipas standardeve statistikore profesionale, të jenë të kënaqshme;

ç) të mbledhë, të grupojë, të analizojë, të shpërndajë dhe të ruajë të dhënat, në përputhje me përgjegjësitë e ngarkuara në program;

d) të përgatisë projektprogramin pesëvjeçar;

dh) të përgatisë projektplanin strategjik pesëvjeçar;

e) të përgatisë projektbuxhetin vjetor;

ë) të përgatisë projektplanin e veprimit njëvjeçar;

f) të përgatisë projektin e raportit vjetor;

g) të përgatisë dhe t'i dorëzojë Këshillit të Statistikave raporte të shkurtra 4-mujore për ecurinë në zbatimin e programit;

gj) t'i propozojë Këshillit të Statistikave çështje, të cilat këshilli duhet t'i shqyrtojë dhe diskutojë drejtpërdrejt me drejtues të lartë të agjencive statistikore, për të siguruar që çdo statistikë zyrtare të përmbushë standardet profesionale;

h) të përgatisë projektraporte për shqyrtim nga Këshilli i Statistikave, duke propozuar veprime ose vendime të kërkuara nga Këshilli i Ministrave, të cilat sigurojnë se çdo statistikë zyrtare përmbush standardet profesionale;

i) të organizojë dhe të kryesojë çdo 3 muaj takime të zgjeruara këshillimore me drejtuesit e strukturave, që ndjekin çështjet e statistikave, në ministri dhe në agjencitë e tjera statistikore, për çështje të interesave profesionale dhe një herë në vit për diskutimin e realizimit të programit, problemet dhe veprimet e nevojshme për përmirësimin e tij;

j) të botojë, përpara përfundimit të vitit kalendarik, një kalendar të hollësishëm të datave, në të cilat do të shpërndahen statistikën zyrtare të veçanta, si dhe të përcaktojë formën e shpërndarjes;

k) të hartojë, të negociojë e të nënshkruajë memorandume mirëkuptimi me të gjitha agjencitë statistikore dhe me mbajtësit e të dhënave administrative, që janë përdorur në nxjerrjen e programit, duke përfshirë organizimet e punës dhe detyrimet dypalëshe;

l) me kërkesë të agjencive statistikore, të hartojë kriteret e aftësitë profesionale për përzgjedhjen e drejtuesve të strukturave që merren me statistikën;

ll) të sigurojë funksionimin e Sekretariatit të Këshillit të Statistikave;

m) të drejtojë Komisionin Kombëtar për Nomenklaturën.

2. INSTAT-i ka të drejtë:

a) të kërkojë nga agjencitë statistikore të dhëna për ecurinë e detyrave të caktuara në program;

b) të kërkojë nga ministrinë dhe institucionet qendrore dhe vendore shfrytëzimin e të dhënave administrative dhe statistikore, përveç të drejtave të tjera, të specifikuara në program;

c) të ndërmarrë çdo veprimtari tjetër për përmbushjen e përgjegjësi e të detyrave, siç janë përcaktuar në këtë ligj;

ç) të ndërmarrë ose të kontribuojë në analizat dhe veprimtaritë kërkimore, në të cilat statistikatat zyrtare janë të dhëna të rëndësishme.

Neni 9

Statusi dhe financimi i INSTAT-it

1. INSTAT-i është person juridik publik.

2. Organet drejtuese të INSTAT -it janë:

a) Këshilli i Statistikave;

b) Drejtori i Përgjithshëm.

3. Drejtori i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri me propozimin e Këshillit të Statistikave.

4. Nëpunësit e INSTAT-it, specialistët dhe drejtuesit gëzojnë statusin e nëpunësit civil, ndërsa për punonjësit e tjerë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

Rekrutimi i nëpunësve të INSTAT-it bëhet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr.8549 datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

5. Punonjësit ekzistues të Institutit të Statistikave, të cilët në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, punojnë në vende pune që konsiderohen pjesë e shërbimit civil, janë nëpunës në periudhë prove për 1 vit.

6. INSTAT-i financohet nga Buxheti i Shtetit, nga ushtrimi i veprimtarisë, nëpërmjet pagesës për botime e shërbime, nëpërmjet projekteve, si dhe nga çdo e ardhur tjetër e ligjshme që mund të shërbejë si burim për rritjen e të ardhurave.

Neni 10

Këshilli i Statistikave

1. Këshilli i Statistikave përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë që emërohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Rregulla të hollësishme për kriteret dhe procedurat e përfaqësimit, përzgjedhjes, emërimit e shkarkimit të anëtarëve, si dhe rregullat e funksionimit të Këshillit të Statistikave miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 11

Roli dhe detyrat e Këshillit të Statistikave

1. Këshilli i Statistikave duhet të mbikëqyrë dhe të mbështesë INSTAT-in në rolin e tij për të siguruar se programi është hartuar në përputhje me parimet themelore të Kombeve të Bashkuara për statistikatat zyrtare. Për të plotësuar këtë rol, përveç veprimtarive të tjera, të përcaktuara në këtë ligj, ai kryen detyrat e mëposhtme:

a) miraton projektprogramin, ndryshimet e tij dhe nëpërmjet Kryeministrit ose ministrit ia paraqet për miratim Kuvendit;

b) miraton planin strategjik pesëvjeçar të INSTAT-it, i cili përfshin masat për realizimin e programit;

c) miraton planveprimin njëvjeçar të INSTAT-it;

ç) miraton projektbuxhetin vjetor;

d) miraton projektstrukturën organizative të INSTAT-it;

dh) miraton raportin vjetor të INSTAT-it;

e) shqyrton raportet e shkurtra katërmujore të ecursisë në zbatimin e programit, të paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm.

2. Këshilli i Statistikave, për të përmbushur rolin e tij:

a) diskuton drejtpërdrejt me drejtuesit e strukturave, që merren me statistikat, në ministri dhe agjencitë e tjera statistikore për çështje që kërkojnë mbështetjen ose veprimin e agjencive, për të siguruar që çdo statistikë zyrtare të përmbushë standardet profesionale;

b) përgatit ose dorëzon raporte në Këshillin e Ministrave që kërkojnë vendimin e këtij këshilli për të siguruar që çdo statistikë zyrtare të përmbushë standardet profesionale;

c) kërkon vlerësim, llogaritje ose kontroll të pavarur nga ekspertë të jashtëm për një fushë të caktuar të statistikave zyrtare. Kostoja për këto veprimtari do të mbulohet nga buxheti i INSTAT-it.

Neni 12

Detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT -it:

a) përgatit propozime për t'u miratuar nga Këshilli i Statistikave mbi strukturën organizative të INSTAT-it ose për ta ndryshuar atë, sipas shkronjës "d" të pikës 1 të nenit 11 të këtij ligji;

b) propozon emërimin e stafit në nivel drejtori, për t'u miratuar nga Këshilli i Statistikave;

c) përfaqëson INSTAT-in në marrëdhëniet me të tretët;

ç) përgatit çdo vit propozimet për modifikime në program, të cilat paraqiten për miratim në Këshillin e Statistikave;

d) miraton emërimin e shefit të departamentit të statistikave të çdo agjencie statistikore; kriteri për miratim duhet të jetë kompetenca profesionale e personit të propozuar;

dh) ndjek të gjitha mbledhjet e Këshillit të Statistikave dhe merr pjesë në diskutim, por pa të drejtë vote;

e) zbaton detyra të tjera që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Detyrat dhe misioni i agjencive të tjera

1. Agjencitë statistikore shqiptare dhe institucionet qendrore e vendore, të cilat kontribuojnë për statistikat për t'i përfshirë ato në program, do t'i sigurojnë INSTAT-it të gjitha dokumentet dhe të dhënat e nevojshme, për ta lejuar atë të përmbushë detyrimet, sipas shkronjës "b" të pikës 1 të nenit 8 të këtij ligji.

2. Të gjitha agjencitë statistikore:

a) i japin INSTAT-it çdo të dhënë të kërkuar, në përputhje me shkronjën "a" të pikës 2 të nenit 8 të këtij ligji;

b) përmbushin të gjitha detyrimet e vëna në program;

c) njoftojnë INSTAT-in për kontaktet e tyre me agjencitë ndërkombëtare, për çështje që lidhen me statistikat.

3. Të gjitha institucionet qendrore dhe vendore i japin INSTAT-it të drejtën e hyrjes në regjistrat, skedarët e të dhënave dhe të dhënat e mbledhura, të përpunuara dhe ruajtura, sipas përgjegjësisë përkatëse, në masën që është e nevojshme për nxjerrjen e statistikave, duke shmangur ngarkesat në përgjigje për njësitë statistikore.

4. Nuk do të bëhet asnjë pagesë nga INSTAT-i për çdo lloj detyre të ndërmarrë nga agjencitë e tjera, në lidhje me pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 14

Të drejtat dhe detyrimet e njësive statistikore

1. Njësitë statistikore, të kërkuara për të siguruar të dhëna për nxjerrjen e statistikave zyrtare brenda programit, njoftohen për qëllimin dhe synimin e vërtetimit, për të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe masat që duhet të merren për të siguruar konfidencialitetin statistikor.

2. Njësitë statistikore, të kërkuara për të dhënë njoftim për programin si: ndërmarrjet, institucionet, personat fizikë dhe juridikë, do t'i japin të dhënat e kërkuara, tërësisht dhe me

vërtetësi, INSTAT-it ose agjencive të tjera statistikore, të përmendura në program. Të dhënat do të sigurohen pa pagesë, në formën dhe kohën e kërkuar.

Neni 15 Konfidencialiteti

1. Të dhënat e nxjerra nga burimet e disponueshme publikisht nuk do të vlerësohen konfidenciale.

2. Të dhënat e mbledhura, të përpunuara dhe të ruajtura për nxjerrjen e statistikave zyrtare do të trajtohen si konfidenciale nga INSTAT-i, agjencitë statistikore dhe çdo organizatë ose person i caktuar prej tyre, kur këto të dhëna bëjnë që njësitë statistikore të identifikohen drejtpërdrejt ose tërthorazi, duke zbuluar të dhëna individuale, që nuk janë bërë publike për arsye të tjera.

3. Një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore duhet t'i heqin identifikuesit e drejtpërdrejtë sa më shpejt që të jetë e mundur.

4. Identifikimi i tërthortë është mundësia për të kuptuar identitetin e një njësie statistikore, me përjashtim të rastit të të dhënave të pikës 3 të këtij neni. Për të përcaktuar nëse një njësi statistikore është tërthorazi e identifikueshme, do të merren parasysh të gjitha masat e arsyeshme për identifikimin e njësisë statistikore në fjalë. Për mbrojtjen e identifikimit, përfshihen në total të paktën tri njësi dhe pjesa e një njësie nuk duhet të kalojë 85 për qind të totalit.

5. Të gjitha të dhënat individuale të mbledhura nga njësia statistikore për nxjerrjen e statistikave zyrtare do të përdoren vetëm për qëllime statistikore. Këto të dhëna do të botohen vetëm bashkërisht dhe nuk do të përdoren për të marrë ndonjë vendim administrativ, duke përfshirë këtu vendime për kontrollin fiskal ose hetime juridike.

6. E drejta e hyrjes në të dhënat konfidenciale do të kufizohet për personat, të cilët, gjatë kryerjes së detyrave, kontribuojnë në nxjerrjen e statistikave zyrtare. E drejta e hyrjes do të shtrihet në masën që për këto të dhëna është i nevojshëm për nxjerrjen e statistikave në fjalë. E drejta e hyrjes për qëllime kërkimore-shkencore do të kufizohet në përputhje me pikën 7 të këtij neni.

7. E drejta e hyrjes në të dhënat konfidenciale për projekte kërkimore-shkencore mund të jepet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it për një periudhë të kufizuar, duke siguruar se të dhënat nuk lejojnë identifikimin e drejtpërdrejtë. Marrësi duhet të nënshkruajë një kontratë me INSTAT-in, sipas së cilës:

a) sigurohet se rezultati i parashikuar nuk u referohet njërive të identifikueshme ose nuk lejon identifikimin e tërthortë;

b) sigurohet standardi i mbrojtjes së të dhënave konfidenciale, brenda projektit të kërkimit;

c) ka një detyrim të zhdurë menjëherë të dhënat, sapo projekti përfundon, duke njoftuar me shkrim INSTAT-in për këtë veprim.

8. Statistikat zyrtare nuk mund t'u jepen përdoruesve, duke zbuluar të dhëna konfidenciale. Për të ndihmuar mbrojtjen kundrejt identifikimit, totali do të përfshijë të paktën tri njësi dhe pjesa e një njësie në total nuk duhet të kalojë normalisht 85 për qind të totalit. Përjashtim nga ky rregull bën informacioni rreth gjendjes ekonomike të mbledhur nga ndërmarrjet dhe agjentët ekonomikë, i cili mund të shpërndahej edhe kur rezultatet nuk përmbushin kërkesat e fjalisë së dytë të këtij paragrafi, në rastet kur është e nevojshme për të siguruar një informacion të rëndësishëm të parashikuar në programin e statistikave zyrtare.

9. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore marrin të gjitha masat e duhura teknike, organizative dhe të sigurimit për mbrojtjen nga çdo hyrje, zbulim ose përdorim i paligjshëm i të dhënave konfidenciale.

Neni 16

Lidhja e statistikave zyrtare me të dhënat administrative

1. INSTAT-i përcakton metodologjitë statistikore të përdorura për prodhimin e statistikave administrative.

2. INSTAT-i bën publike dhe funksionale udhëzimet mbi standardet profesionale në nxjerrjen e statistikave zyrtare.

3. INSTAT-i vihet në dijeni për çdo vërtetim statistikor, duke përfshirë dhe ato që janë jashtë programit, të cilat do të ndërmerren nga çdo agjenci statistikore ose institucion qendror apo vendor.

4. INSTAT-i ka të drejtë të marrë dhe të përdorë statistikën administrative dhe detyrohet t'i shpërndajë ato, sipas programit të statistikave zyrtare. Prodhuesit e statistikave administrative duhet të transmetojnë këto statistika me kërkesën e INSTAT-it.

Neni 17

Shpërndarja e statistikave

1. Statistikat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë.

2. Për t'ia dhënë përdoruesit statistikën zyrtare përdoren të gjitha format e mundshme të medias.

3. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta.

4. INSTAT-i dhe të gjitha agjencitë statistikore, që përdorin tarifa për shërbime në shpërndarjen e të dhënave, duhet t'i publikojnë ato.

Neni 18

Kundërvajtjet administrative dhe gjobat

1. Në kuptim të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë shkeljet e mëposhtme:

a) mospërmbushja e detyrimeve, të vendosura në pikën 2 të nenit 14, dënohet me gjobë deri në 5 000 lekë. Për rastet e përsëritura, gjobat janë nga 5 000 lekë deri në 25 000 lekë për çdo shkelje. Për shkeljet e kryera nga institucionet publike gjoba i jepet titullarit të institucionit;

b) moszbatimi ose shkelja e kërkesave të konfidencialitetit, të përcaktuar në nenin 15 nga nëpunësi, përfshirë këtu dhe koha kur ai ka lënë detyrën, ose nga një palë e tretë, së cilës i është dhënë e drejta për qëllime kërkimore dënohet me gjobë nga 20 000 lekë deri në 25 000 lekë.

2. Gjobat vendosen nga:

a) drejtuesi i strukturës përkatëse të këtij institucioni, kur të dhënat janë kërkuar nga INSTAT-i;

b) drejtuesi i agjencisë statistikore, kur të dhënat janë kërkuar nga agjencia statistikore;

c) drejtuesi i strukturës përkatëse të këtij instituti, kur personi është punonjës ose ish-punonjës i INSTAT-it ose një palë e tretë;

ç) drejtuesi i agjencisë statistikore, kur personi është punonjës ose ish-punonjës i agjencisë statistikore.

3. Kundër vendimit të gjobës mund të bëhet ankimi te Drejtori i Përgjithshëm brenda 10 ditëve nga data e shpalljes ose e botimit të gjobës, i cili duhet të përgjigjet brenda 30 ditëve. Kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm, ose kur ai nuk përgjigjet, personi i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës brenda 30 ditëve nga shpallja e vendimit ose nga mospërgjigjja.

Neni 19
Dispozita të fundit

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore, në përputhje me parimet e përgjithshme, të parashikuara në nenin 10 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji.

Neni 20

Ligji nr.7687, datë 16.3.1993 "Për statistikën në Republikën e Shqipërisë", si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4157, datë 2.3.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9181, datë 5.2.2004

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7943, DATË 1.6.1995 "PËR PENSIONET SUPLEMENTARE DHE INSTITUTET PRIVATE TË PENSIONEVE",
NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8393, DATË 20.9.1998**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve", ndryshuar me ligjin nr.8393, datë 20.9.1998, bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pas pikës 7 shtohen pikat 7/1 dhe 7/2 me këtë përmbajtje:

"7/1. Me termin "Institut pensionesh i profesioneve të vështira" kuptohet një institucion financiar, që siguron pensione suplementare dhe përfitime të tjera për punonjësit e një dege të caktuar të ekonomisë, në këmbim të kontributeve të paguara sipas këtij ligji.

7/2. Me termin "Degë e vështirë e ekonomisë" kuptohet ajo degë ku kryhen punë, të cilat, për vështirësinë që paraqesin, janë kategorizuar si punë të kategorisë së parë dhe të dytë, për efekt përfitim pensioni nga sigurimet shoqërore."

2. Në pikën 8 fjalja e dytë shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 4 të bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 1, pas shkronjës "b" shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

"c) Nga punëdhënësit e së njëjtës degë të vështirë të ekonomisë, për të punësuarit e punëdhënësit, të cilët e themelojnë ose i bashkëngjiten atij."

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Instituti i pensioneve të profesioneve të vështira është i mbyllur vetëm për të punësuarit e punëdhënësve të një dege të caktuar të ekonomisë."

Neni 3

Në nenin 8 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Punëdhënësit e degëve të vështira të ekonomisë që kanë krijuar institut pensionesh të profesioneve të vështira ose i janë bashkëngjitur atij, marrin pjesë në fondin e institutit, pavarësisht nga marrëveshja me personat e siguruar."

Neni 4

Në nenin 10, paragrafi i fundit riformulohet si më poshtë:

"Personi i siguruar nuk ka të drejtë t'i transferojë kontributet në një institut tjetër pensionesh kur:

a) ka plotësuar kushtet për pension suplementar;

b) është siguruar në një institut pensionesh të profesioneve të vështira dhe nuk e ka ndërruar punëdhënësin."

Neni 5

Në nenin 11, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Punëdhënësi privat i një dege të vështirë të ekonomisë, me jo më pak se 300 persona të punësuar, ka të drejtë të krijojë një institut privat pensionesh të profesioneve të vështira. Kur instituti privat i pensioneve të profesioneve të vështira krijohet nga më shumë se një punëdhënësi, duhet që njëri prej tyre të ketë të punësuar më shumë se 100 persona dhe të gjithë së bashku të kenë të punësuar jo më pak se 300 persona."

Neni 6

Në nenin 27, shkronja "b" e pikës 4 riformulohet si më poshtë:

"b) detyrimet e të punësuarve dhe të punëdhënësve për të paguar kontribute."

Neni 7

Në nenin 29, fjalia e parë dhe e dytë e pikës 2 zëvendësohen me fjalitë e mëposhtme:

"Punëdhënësi është i detyruar të paguajë në institutin e pensioneve të profesioneve të vështira një kontribut në masën jo më pak se 50 për qind të totalit të kontributit për pjesëmarrje në fond. Kontributet në institutin e pensioneve të profesioneve të vështira paguhën nga i siguruari e punëdhënësi dhe derdhen nga punëdhënësi."

Neni 8

Në nenin 36, pas pikës 2 shtohen pikat 2/1 dhe 2/2 me këtë përmbajtje:

"2/1. Institutet e pensioneve të profesioneve të vështira janë të detyruara:

a) të njoftojnë me shkrim, të paktën një herë në vit, pjesëmarrësit në institut për nivelin e të gjitha të ardhurave të regjistruara për përfitimet e tyre. Ky njoftim duhet të përfshijë bilancin

financiar dhe të dhëna për administrimin e institutit të pensioneve të profesioneve të vështira, personelin e bordit drejtues dhe të këshillit mbikëqyrës, numrin e pjesëmarrësve në institut, si dhe ndryshimet në rregulloren e pensioneve, transferimin e fondeve etj.;

b) të dërgojnë me shkrim të dhëna për nivelin e të ardhurave, të regjistruara në llogarinë e pjesëmarrësit për përfitimin që i takon.

2/2. Rregullorja e pensioneve, të dhënat për administrimin e institutit të pensioneve të profesioneve të vështira, për personelin e bordit drejtues dhe këshillin mbikëqyrës, për numrin e pjesëmarrësve, përfshirë edhe të gjitha ndryshimet në njoftimin e mësipërm, duhet të publikohen në zyrën ku është regjistruar instituti. Këto të dhëna duhet të jenë të vlefshme për të gjithë pjesëmarrësit në institutin e pensioneve të profesioneve të vështira."

Neni 9

Në nenin 37, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Një institut pensionesh i profesioneve të vështira është i detyruar të krijojë fond rezervë për mbulimin e humbjeve dhe për garantimin e pagesës së përfitimeve, i cili të mbulojë të paktën tre muaj shpenzime për përfitime.

Fondi rezervë për mbulimin e humbjeve krijohet nga fitimi i institutit të pensioneve të profesioneve të vështira, si rezultat i investimeve të tij.

Në rast se investimi i institutit të pensioneve të profesioneve të vështira rezulton me humbje dhe fondi rezervë, si dhe çdo fond tjetër i krijuar nga fitimi, janë të pamjaftueshëm për mbulimin e humbjeve, humbjet mbulohen prej të ardhurave të mbledhura në institut për përfitimet e pjesëmarrësve. Humbjet mund të mbulohen edhe me një kredi pa interes ose kredi të garantuara nga punëdhënësi."

Neni 10

Në nenin 38, pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

"8. Një institut pensionesh i profesioneve të vështira është i detyruar të arrijë një nivel minimal fitimi, të barabartë me normën e interesit të konsoliduar të sistemit bankar."

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4158, datë 2.3.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9182, datë 5.2.2004

PËR AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj vendos rregulla për organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e institucionit të Akademisë së Shkencave dhe organeve drejtuese të saj.

Neni 2

1. Akademia e Shkencave (në vazhdim Akademia) është institucion i lartë shkencor i Republikës së Shqipërisë.

2. Akademia ka anëtarë shkencëtarë nga më të shquarit të vendit, që mbajnë titullin "Akademik" dhe përfshin në sistemin e vet institute, qendra e organizma të tjerë shkencorë.

3. Puna kërkimore-shkencore e Akademisë kryhet në institutet, qendrat dhe në organizmat e tjerë, që bëjnë pjesë në sistemin e saj, në mbështetje të programeve shkencore vjetore e disavjeçare.

Neni 3

1. Akademia e Shkencave, si dhe institutet e qendrat kërkimore-shkencore, që bëjnë pjesë në sistemin e saj, janë persona juridikë.

2. Selia e Akademisë së Shkencave është në Tiranë.

3. Akademia ka stemën e vet.

Neni 4

Akademia është institucion buxhetor. Mjetet financiare për veprimtarinë e saj sigurohen nga Buxheti i Shtetit në zë të veçantë, në bazë të programit të problemeve kryesore, shkencore, të paraqitura prej saj. Ato mund të plotësohen edhe nga shërbime tekniko-shkencore që ajo kryen nëpërmjet instituteve të veta për persona juridikë e fizikë, jashtë sistemit të saj, si dhe nga aplikime, projekte, dhurata, subvencione e sponsorizime, të cilat përdoren në përputhje me ligjet në fuqi.

Neni 5

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton kushte për funksionimin e Akademisë së Shkencave.

Neni 6

1. Akademia ka pavarësi shkencore. Ajo vepron sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe Statutit të vet, duke e mbështetur organizimin dhe drejtimin e saj në këtë ligj dhe në Statutin e miratuar prej saj.

2. Akademia është institucion autonom, që e bazon në veprimtarinë e vet në të vërtetën shkencore dhe interesat kombëtarë.

3. Arritjet e veprimtarisë kërkimore-shkencore të Akademisë vihen në shërbim të shoqërisë dhe shtetit, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU II FUNKSIONET E AKADEMISË SË SHKENCAVE

Neni 7

Akademia ka këto funksione:

a) kryen kërkime dhe studime me karakter teorik dhe praktik në fusha të ndryshme të shkencave albanologjike, shoqërore, natyrore e teknike dhe ndihmon për zbatimin e këtyre studimeve;

b) kujdeset për të hapur fusha të reja kërkimesh e studimesh shkencore, në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit;

c) u ofron institucioneve të larta shtetërore këshillimin dhe ekspertizën e nevojshme në zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme për zhvillimin e vendit;

ç) përpunon, së bashku me organet shtetërore përkatëse, rekomandime për shfrytëzimin efektiv të arritjeve tekniko-shkencore në zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit;

d) bashkëpunon me institucione dhe qendra të tjera shkencore;

dh) kujdeset për të përhapur dhe thelluar njohuritë shkencore;

e) kujdeset për të drejtat e anëtarëve të vet dhe të punonjësve të tjerë shkencorë, për krijimin e kushteve të përshtatshme jetësore e materiale, që ata të merren me veprimtari shkencore;

ë) përkrah dhe nxit pjesëmarrjen aktive të shoqatave, të fondacioneve shkencore dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm në veprimtarinë shkencore;

f) kujdeset për kualifikimin e vazhdueshëm të punonjësve të institucioneve të saj dhe programon, planifikon dhe nxit veprimtarinë e tyre për mbrojtjen dhe fitimin e gradave e të titujve shkencorë, sipas dispozitave ligjore.

Neni 8

Akademia bashkëpunon me universitetet dhe shkollat e tjera të larta, duke synuar integrimin sa më efektiv të punës kërkimore me atë mësimore.

Neni 9

Akademia e Shkencave:

a) financon programe të veçanta të kërkimit shkencor, të ndërmarra me nismën e një ose disa shkencëtarëve;

b) formon komisione e grupe pune të përhershme ose të përkohshme për organizimin e studimeve ndërdisiplinore me pjesëmarrjen e punonjësve shkencorë, brenda dhe jashtë Akademisë;

c) organizon kongrese dhe konferenca në shkallë kombëtare e ndërkombëtare;

ç) organizon këshillime shkencore e mbledhje të tjera për shqyrtimin dhe trajtimin e çështjeve të caktuara;

d) boton rezultatet e punës shkencore të saj, organe periodike dhe vepra të tjera me vlerë shkencore, në veçanti për trashëgiminë kulturore të popullit shqiptar;

dh) organizon konkurse dhe dhënie çmimesh shkencore.

Neni 10

Akademia vendos e zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione shkencore të vendeve të tjera. Ajo ndihmon në bashkërendimin e veprimtarisë së organizmave të ndryshëm shkencorë, që funksionojnë pranë saj, në organizata shkencore ndërkombëtare, për arritjen e një integrimi sa më të frytshëm të saj në shkencën botërore.

KREU III ANËTARËT E AKADEMISË SË SHKENCAVE

Neni 11

1. Anëtarë të Akademisë (akademikë) zgjidhen shkencëtarë nga më të shquarit me titull "Profesor" ose "Drejtues kërkimesh", me shtetësi shqiptare, të cilët, nëpërmjet punimeve origjinale, veprave përgjithësuese ose projekteve të një niveli të lartë shkencor, kanë zgjidhur teorikisht dhe praktikisht probleme të një rëndësie të veçantë në fushën e shkencës, të ekonomisë ose të kulturës, kanë dhënë ndihmesë shumë të rëndësishme në formimin shkencor, universitar e pasuniversitar të specialistëve e shkencëtarëve të rinj.

2. Në raste të veçanta anëtarë të Akademisë mund të zgjidhen edhe personalitete që kanë merita të shquara në fushën e krijimtarisë letrare dhe artistike.

3. Anëtarët e Akademisë mbajnë për tërë jetën titullin "Akademik", me përjashtim të rastit kur mbajtësi heq dorë vullnetarisht prej titullit.

4. Anëtarët e Akademisë me banim të përhershëm në Shqipëri marrin pagën përkatëse, sipas tabelës së pagave të miratuar nga Këshilli i Ministrave, të cilën e përfitojnë për të gjithë kohën e anëtarësimit.

Neni 12

1. Anëtarët e Akademisë formojnë Senatin Akademik (në vazhdim Senati), i cili ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e parashikuara në ligj dhe në Statutin e Akademisë.

2. Senati përbëhet nga jo më shumë se 45 anëtarë.

Neni 13

Personat, që kanë funksione të larta shtetërore nuk mund të kandidojnë për t'u zgjedhur anëtarë të Akademisë gjatë ushtrimit të funksioneve të mësipërme.

Neni 14

1. Akademia e Shkencave mund të ketë edhe anëtarë të jashtëm nga dijetarë të shquar të vendeve të tjera dhe anëtarë nderi, të cilët nuk kanë të drejtë vote.

2. Propozimet për pranimin e anëtarëve të rinj, të anëtarëve të jashtëm dhe të anëtarëve të nderit, si dhe pranimi i tyre bëhen sipas procedurës së përcaktuar në Statutin e Akademisë.

KREU IV DREJTIMI I AKADEMISË SË SHKENCAVE

Neni 15

Organet drejtuese të Akademisë së Shkencave janë Asambleja, Këshilli Ekzekutiv dhe Kryesia e Akademisë.

Neni 16

1. Asambleja është organi më i lartë drejtues i Akademisë dhe përbëhet nga anëtarët e Akademisë, drejtorët e institucioneve kërkimore-shkencore të Akademisë, sekretarët shkencorë të seksioneve dhe nga një punonjës shkencor me titullin “Profesor” ose “Drejtues kërkimesh” për secilin nga këto institucione kërkimore-shkencore (kur ka të tillë), që zgjidhet me votim të fshehtë e me mandat katërvjeçar nga këshilli shkencor i institucionit përkatës.

2. Rregullat e mbledhjes dhe të funksionimit të Asamblesë përcaktohen në Statutin e Akademisë, i cili miratohet nga vetë Asambleja.

3. Këshilli Ekzekutiv përbëhet nga 9 anëtarë dhe konkretisht: nga Kryetari, dy zëvendëskryetarët, Sekretari Shkencor i Akademisë dhe nga pesë anëtarë nga radhët e drejtorëve të institucioneve të sistemit të Akademisë, të zgjedhur me votim të fshehtë nga Asambleja. Kryetari i Akademisë, pas këshillimit me të gjithë drejtorët, propozon zgjedhjen e drejtorëve për në Këshillin Ekzekutiv.

4. Përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të Këshillit Ekzekutiv përcaktohen në Statutin e Akademisë.

5. Kryetari i Akademisë, zëvendëskryetarët dhe Sekretari Shkencor përbëjnë Kryesinë e Akademisë.

6. Kryetari, zëvendëskryetarët dhe Sekretari Shkencor mund të rizgjidhen në të njëjtin funksion, por vetëm një herë radhazi.

Neni 17

1. Kryetari i Akademisë duhet të jetë akademik. Zgjedhja e tij bëhet drejtpërdrejt, pa propozim paraprak dhe me votim të fshehtë nga anëtarët e Akademisë dhe nga drejtorët e institucioneve të saj.

2. Kryetari i zgjedhur i Akademisë emërohet nga Presidenti i Republikës.

3. Kryetari propozon nga radhët e akademikëve kandidatët për zëvendëskryetarë, për Sekretar Shkencor dhe për kryetar të seksioneve. Zgjedhja e tyre bëhet sipas procedurës së përcaktuar në Statutin e Akademisë.

4. Kryetari i Akademisë, zëvendëskryetarët dhe kryetarët e seksioneve kanë mandat katërvjeçar, ndërsa Sekretari Shkencor ka mandat pesëvjeçar.

5. Struktura dhe organika e aparatit të Akademisë miratohen nga Këshilli Ekzekutiv i Akademisë.

Neni 18

1. Përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të Kryesisë përcaktohen në statutin e Akademisë.

2. Kryesia e Akademisë ka aparatit e vet, struktura dhe funksionimi i të cilit përcaktohen sipas një rregulloreje të miratuar nga Kryesia. Aparati ndihmon institucionet e Akademisë për realizimin e veprimtarisë së tyre shkencore dhe administrative.

KREU V SEKSIONET E AKADEMISË SË SHKENCAVE

Neni 19

1. Seksionet e Akademisë janë njësi shkencore e organizative, të cilat, në përshtatje me vendimet e Asamblesë, të Këshillit Ekzekutiv dhe të Kryesisë së Akademisë, realizojnë detyrat e përcaktuara në këtë ligj dhe në Statutin e Akademisë.

2. Seksionet ndahen në:

- a) seksionin e shkencave shoqërore e albanologjike;
- b) seksionin e shkencave natyrore e teknike.

Neni 20

Përbërja, mënyra e drejtimit dhe e funksionimit të seksionit përcaktohen në Statutin e Akademisë.

KREU VI INSTITUCIONET E AKADEMISË SË SHKENCAVE

Neni 21

1. Në sistemin e Akademisë bëjnë pjesë institucionet kërkimore-shkencore, që kryejnë kërkime thelbësore e aplikative në fushën e shkencave albanologjike, shoqërore, natyrore e teknike.

2. Institucionet shkencore të Akademisë janë organizma të mëvetësishëm, që kryejnë veprimtari të pavarur kërkimore-shkencore në një ose disa fusha që mbulojnë. Për rezultatet e punës dhe veprimtarinë ekonomiko-financiare ato përgjigjen sipas ligjit.

3. Asambleja e Akademisë përcakton drejtimet themelore të veprimtarisë kërkimore-shkencore të këtyre institucioneve në përputhje me strategjinë e zhvillimit të vendit.

4. Krijimi ose përfshirja e institucioneve të reja në sistemin e Akademisë, si dhe shkëputja e institucioneve ekzistuese nga ky sistem bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, pasi është marrë mendimi i Asamblesë së Akademisë.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 22

Pagat e Kryetarit të Akademisë, të zëvendëskryetarëve, të Sekretarit Shkencor dhe të administratës së Akademisë caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 23

1. Të ardhurat financiare që sigurojnë institucionet e Akademisë, në bazë të parimeve të ekonomisë së tregut, nga projektet, shërbimet tekniko-shkencore, veprimtaritë fitimprurëse për të tretë, si dhe nga donacionet përdoren sipas akteve ligjore dhe nënligjore, të përcaktuara për përdorimin e të ardhurave të krijuara.

2. Shteti, me anë të sistemit të taksave, tatimeve dhe kreditimeve, favorizon zhvillimin e veprimtarisë shkencore të institucioneve të Akademisë, për të rritur nivelin e financimit nga burime të tjera, në raport me financimin nga buxheti.

Neni 24

Organet drejtuese në sistemin e Akademisë, të zgjedhura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë punën deri në mbarimin e mandatit të tyre.

Neni 25 Shfuqizimet

Neni 18 i ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 "Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik", si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4159, datë 2.3.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9183, datë 5.2.2004

**PËR DISIPLINËN USHTARAKE NË FORCAT
E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Baza juridike

Ligji për disiplinën në Forcat e Armatosura mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në parimet e përgjithshme të së drejtës ushtarake ndërkombëtare, në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe në ligjet e tjera.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij ligji janë disiplina ushtarake në Forcat e Armatosura, shkeljet e saj, që nuk përbëjnë veprë penale ushtarake, të parashikuara në Kodin Penal Ushtarak dhe në Kodin Penal, si dhe përcaktimi i masave disiplinore, që merren ndaj subjekteve që i kryejnë ato, procedurat e dhënies së masave, autoritetet përgjegjëse për dhënien e tyre dhe e drejta për t'u ankuar ndaj masës disiplinore.

Neni 3
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim forcimin e disiplinës ushtarake, të rendit ushtarak dhe të autoritetit në Forcat e Armatosura nga shkeljet disiplinore, me synim parandalimin e tyre, për të siguruar përmbushjen e misionit kushtetues të këtyre forcave.

Neni 4
Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Shkelje disiplinore" është veprimi ose mosveprimi i kryer në kundërshtim me këtë ligj nga ushtarakët e Forcave të Armatosura.
2. "Masë disiplinore" janë masat me karakter ndëshkues, të përcaktuara në këtë ligj, që merren ndaj ushtarakëve nga eprori ose komisioni disiplinor, kur ai kryen shkelje disiplinore.
3. "Epror" është ushtaraku i cili, në bazë të gradës dhe funksionit, ushtron autoritet mbi personelin ushtarak.
4. "Vartës" është ushtaraku në një repart ose njësi ushtarake, i cili është nën autoritetin e një personi që ka gradë ose funksion më të lartë.

5. "Komision disiplinor" është një grup i përbërë nga jo më pak se tre oficerë, që mbledhen me urdhër të autoritetit përgjegjës për të shqyrtuar shkeljet e përcaktuara në këtë ligj, të kryera nga ushtarakët subjekt të këtij ligji dhe për të dhënë masat që parashikohen në këtë ligj.

6. "Ushtaraku" është shtetasi që shërben në Forcat e Armatosura si ushtarak i shërbimit aktiv, si oficer, nënoficer, ushtar profesionist dhe ushtarakët e shërbimit të detyrueshëm, si edhe ushtarakët në rezervë kur janë në shërbim aktiv, për stërvitje ose shërbim gjatë një mobilizimi ushtarak.

KREU II PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE

Neni 5 Personat subjekt i këtij ligji

Përgjigjen sipas këtij ligji:

a) ushtarakët e shërbimit aktiv të Forcave të Armatosura, që shërbejnë si oficerë, nënoficerë, ushtarë profesionistë dhe ushtarakët e shërbimit të detyrueshëm;

b) ushtarakët në rezervë, kur janë në shërbim ushtarak, për stërvitje ose shërbim gjatë një mobilizimi ushtarak.

Neni 6 Juridiksioni territorial

Ky ligj është i zbatueshëm edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për ushtarakët shqiptarë që kryejnë një shkelje disiplinore ushtarake, në rastet kur ata janë dërguar me mision, stërvitje të përbashkët ose në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Neni 7 Autoritetet përgjegjëse

1. Autoritete përgjegjëse për dhënien e masave disiplinore në Forcat e Armatosura janë:

a) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm:

i) për personelin ushtarak të Shtabit të Përgjithshëm dhe të Ministrisë së Mbrojtjes;

ii) për komandantët, zëvendëskomandantët dhe shefat e shtabeve të forcave;

iii) për komandantët, zëvendëskomandantët dhe shefat e shtabeve të komandave të mbështetjes;

iv) për komandantët, zëvendëskomandantët dhe shefat e shtabeve të reparteve të varësisë së drejtpërdrejtë të Shtabit të Përgjithshëm;

v) për drejtorët dhe zëvendësit e tyre (personel ushtarak) në institucionet e varësisë së drejtpërdrejtë të Shtabit të Përgjithshëm;

b) komandantët në nivel kompanie e lart për ushtarakët vartës të tyre, përveç atyre të përcaktuar në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni;

c) komisioni disiplinor në nivel batalioni e lart, përveç Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

2. Komandantët eprorë ose drejtuesit civilë të çdo niveli, të cilët kanë të drejtë t'u rekomandojnë autoriteteve të parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni, fillimin e procedurës për shkelje disiplinore të kryera nga vartësit e tyre.

Neni 8 Komisioni disiplinor

1. Për shqyrtimin e shkeljes disiplinore të ushtarakut të Forcave të Armatosura dhe dhënien e masës disiplinore ndaj tij, në strukturat e nivelit batalion e lart, ngrihen dhe funksionojnë komisionet disiplinore me jo më pak se tre oficerë të strukturës përkatëse.

2. Vendimi i komisionit disiplinor miratohet nga komandanti i repartit ku është organizuar ky komision.

3. Mënyra e organizimit, përbërja dhe funksionimi i komisioneve disiplinore përcaktohen me rregullore të miratuar nga Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Neni 9

Përshtatshmëria e masës disiplinore

Në përcaktimin e përshtatshmërisë së një mase disiplinore, për një shkelje disiplinore të caktuar, merren parasysh rrezikshmëria e shkeljes disiplinore, shkalla e përgjegjësisë, rrethanat në të cilat është kryer shkelja, pasojat, mosha, rezultatet e vlerësimit individual, sjellja e përgjithshme, si dhe nëse i proceduari ka marrë masë disiplinore të mëparshme, e cila nuk është shlyer në kushtet e nenit 10 të këtij ligji.

Neni 10

Rehabilitimi

Quhet i pandëshkuar ushtaraku, ndaj të cilit është marrë masë disiplinore për një shkelje disiplinore dhe që gjatë 6 muajve nga koha e përfundimit të ndëshkimit nuk ka kryer shkelje tjetër disiplinore.

Në këto raste, nga dosja personale e ushtarakut hiqen të dhënat që pasqyrojnë shkeljet disiplinore dhe masat e dhëna.

Neni 11

Parashkrimi i shkeljes disiplinore

Procedimi disiplinor nuk mund të fillojë për shkelje disiplinore, kur nga çasti i diktimit të shkeljes kanë kaluar 4 muaj.

Neni 12

Parashkrimi i ekzekutimit të masës disiplinore

Masa disiplinore nuk mund të ekzekutohet, kur nga dita që është dhënë urdhri përfundimtar për shkeljen disiplinore kanë kaluar 4 muaj.

Neni 13

Veprimet lehtësuese dhe faljet

1. Eprori i një shkalle më të lartë mund të ndërmarrë veprime lehtësuese dhe falje ndaj ushtarakut, të cilit i është dhënë masa disiplinore.

2. Veprimet lehtësuese dhe faljet janë:

- a) ulja e masës disiplinore;
- b) heqja e të dhënave për masat disiplinore nga dosja e personelit, në rastet kur nuk ka përfunduar koha e rehabilitimit;
- c) zëvendësimi i një mase disiplinore me një tjetër masë disiplinore më të lehtë;
- ç) falja e masës disiplinore.

3. Veprimet lehtësuese merren vetëm në ato raste kur sjellja e ushtarakut është e mirë dhe dënimi i dhënë është i papërshtatshëm.

Neni 14
Oficeri disiplinor

1. Në çdo strukturë ku krijohen komisionet disiplinore caktohet një oficer disiplinor. Detyra e oficerit disiplinor është grumbullimi, hartimi i dokumenteve të nevojshme për shkeljet disiplinore të ushtarakut dhe paraqitja e tyre para komisionit disiplinor.

2. Oficeri disiplinor është përfaqësues i akuzës në komisionin disiplinor.

KREU III
MASAT DISIPLINORE

Neni 15
Llojet e masave disiplinore

1. Llojet e masave disiplinore që jepen në zbatim të këtij ligji janë:

a) "kufizim në kufij të përcaktuar" është kufizimi i lëvizjes fizike të një ushtaraku, brenda kufijve të përcaktuar të kazermës, me urdhër të shkruar. Një person i kufizuar kryen të gjitha detyrat ushtarake, përveç rasteve kur urdhërohet ndryshe;

b) "ndalim disiplinor" është kufizimi fizik i një ushtaraku, brenda mjediseve të kazermës, me urdhër të shkruar. Ky mjedis mund të jetë një vendbanim ushtarak si: tendë, kabinë në anije ose dhomë. Ushtarakët, gjatë ndalimit, nuk kryejnë detyra ushtarake;

c) "mbajtje e pagës" është mbajtja e pagës mujore për një periudhë të caktuar, në përfundim të së cilës paga e mbajtur i kthehet përsëri ushtarakut;

ç) "gjobitje në pagë" është ndalimi i një pjese të pagës mujore, pa të drejtë rimarrjeje;

d) "detyra shtesë" janë detyra të tjera (përfshirë edhe punët fizike) që i jepen ushtarakut si ndëshkim, përveç detyrës së zakonshme.

Ushtarit nuk i jepen detyra shtesë, të cilat përbëjnë rrezikshmëri për jetën dhe shëndetin e tij, ose që janë mizore dhe të pazakonta. Oficerët dhe nënoficerët nuk dënohen me detyrë shtesë;

dh) "ulje në gradë" është ulja një gradë deri në një nivel më poshtë vetëm për ushtarët, e cila jepet vetëm nga komandanti, që ka autoritetin e gradimit të këtyre ushtarakëve. Autoriteti i komisionit disiplinor për të dhënë dënimin me ulje grade është në varësi të gradës që e ka të drejtë për ta dhënë komandanti, i cili urdhëron mbledhjen e komisionit disiplinor;

e) "masa disiplinore të lehta" janë këshillimi, vlerësimi jo i mirë, qortimi, detyrat dhe stërvitja shtesë.

Ato jepen nga eprorët e drejtpërdrejtë, për të përmirësuar sjelljen dhe kryerjen e detyrës nga vartësit e tyre. Këto masa jepen me gojë.

2. Për ushtaraket femra nuk zbatohen masat disiplinore të përcaktuara në shkronjat "b" dhe "d" të pikës 1 të këtij neni.

Neni 16
Klasifikimi i shkeljeve disiplinore

1. Shkeljet disiplinore ndahen në shkelje të lehta dhe në shkelje të rënda disiplinore.

2. Shkelje të lehta janë ato që cenojnë rregullat e mirësjelljes e të etiketës ushtarake, të përcaktuara në rregulloret ushtarake, ndaj të cilave jepen masat disiplinore të parashikuara në shkronjën "e" të pikës 1 të nenit 15 të këtij ligji.

3. Shkelje të rënda disiplinore janë ato që cenojnë rëndë disiplinën ushtarake, ndaj të cilave merren masat disiplinore të përcaktuara në shkronjat "a" deri "dh" të pikës 1 të nenit 15 të këtij ligji.

Neni 17

Masat disiplinore, që jepen nga oficerët me gradë madhore

1. Ushtaraku me gradë gjeneral-leitnant, për ushtarakët e varësisë së drejtpërdrejtë, jep për shkeljet që përcaktohen në këtë ligj këto masa:

a) ndaj oficerëve dhe nënoficerëve:

- i) "ndalim disiplinor", por jo më shumë se 7 ditë me radhë;
- ii) "kufizim në kufij të përcaktuar", por jo më shumë se 30 ditë;
- iii) "mbajtje page" në masën jo më shumë se 1/2 e pagës mujore për 3 muaj;
- iv) "gjykitje në pagë" me jo më shumë se 1/8 e pagës për 2 muaj.

b) ndaj studentëve ushtarakë, ushtarëve profesionistë dhe ushtarëve aktivë:

- i) masat e parashikuara në paragrafët "i" dhe "ii" të shkronjës "a" të pikës 1 të këtij neni;
- ii) ulje në gradë, një nivel më poshtë, vetëm për ushtarët profesionistë e aktivë;
- iii) detyra shtesë, jo më shumë se 8 fundjava, vetëm për studentët ushtarakë, ushtarët profesionistë e aktivë.

2. Ushtaraku me gradë gjeneral-major, për shkeljet që përcaktohen në këtë ligj jep për ushtarakët e varësisë së drejtpërdrejtë këto masa:

a) ndaj oficerëve dhe nënoficerëve:

- i) "ndalim disiplinor", për jo më shumë se 7 ditë me radhë;
- ii) "kufizim në kufij të përcaktuar", për jo më shumë se 30 ditë;
- iii) "mbajtje page" në masën jo më shumë se 1/2 e pagës mujore për 3 muaj;
- iv) "gjykitje në pagë" jo më shumë se 1/8 e pagës për 2 muaj.

b) ndaj studentëve ushtarakë dhe ushtarëve profesionistë e aktivë:

- i) masat e parashikuara në paragrafët "i" dhe "ii" të shkronjës "a" të pikës 2 të këtij neni;
- ii) "ulje në gradë", një nivel më poshtë, vetëm për ushtarët profesionistë e aktivë;
- iii) "detyra shtesë", jo më shumë se 8 fundjava, vetëm për studentët ushtarakë, ushtarët profesionistë e aktivë.

3. Ushtaraku me gradën gjeneral-brigade, për shkeljet që përcaktohen në këtë ligj, jep për ushtarakët e varësisë së drejtpërdrejtë këto masa:

a) ndaj oficerëve dhe nënoficerëve:

- i) "ndalim disiplinor", për jo më shumë se 5 ditë me radhë;
- ii) "kufizim në kufij të përcaktuar", për jo më shumë se 30 ditë;
- iii) "mbajtje page" në masën jo më shumë se 1/2 e pagës mujore për 2 muaj;
- iv) "gjykitje në pagë" jo më shumë se 1/12 e pagës për 2 muaj;

b) ndaj studentëve ushtarakë dhe ushtarëve profesionistë e aktivë:

- i) masat e parashikuara në paragrafët "i" dhe "ii" të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni;
- ii) "ulje në gradë", një nivel më poshtë, vetëm për ushtarët profesionistë e aktivë;
- iii) "detyra shtesë", jo më shumë se 7 fundjava, vetëm për studentët ushtarakë, ushtarët profesionistë e aktivë.

Neni 18

Masat disiplinore që jepen nga ushtarakët me gradë kolonel, si dhe ekuivalentët në Forcat Detare

Ushtaraku me gradën kolonel, si dhe ekuivalentët në Forcat Detare, për shkeljet që përcaktohen në këtë ligj, jep për ushtarakët e varësisë së drejtpërdrejtë këto masa:

a) ndaj oficerëve dhe nënoficerëve:

- i) "ndalim disiplinor", për jo më shumë se 5 ditë me radhë;
- ii) "kufizim në kufij të përcaktuar", për jo më shumë se 15 ditë;
- iii) "mbajtje page" në masën jo më shumë se 1/2 e pagës mujore për 2 muaj;
- iv) "gjykitje në pagë" jo më shumë se 1/16 e pagës për 2 muaj;

b) ndaj studentëve ushtarakë dhe ushtarëve profesionistë e aktivë:

- i) masat e parashikuara në paragrafët "i" dhe "ii" të shkronjës "a" të këtij neni;

- ii) "uljen në gradë" një nivel më poshtë vetëm për ushtarët profesionistë e aktivë;
- iii) "detyra shtesë" jo më shumë se 5 fundjava, vetëm për studentët ushtarakë, ushtarët profesionistë e aktivë;
- iv) "detyra shtesë", duke përfshirë punë të rëndë ose detyra të tjera, për jo më shumë se 5 ditë me radhë.

Neni 19

Masat disiplinore që jepen nga ushtaraku me gradë nënkolonel ose major, si dhe ekuivalentët në Forcat Detare

Ushtaraku me gradën nënkolonel ose major, si dhe ekuivalentët në Forcat Detare, për shkeljet që përcaktohen në këtë ligj, jep për ushtarakët e varësisë së drejtpërdrejtë këto masa:

- a) ndaj oficerëve dhe nënoficerëve:
 - i) "ndalim disiplinor", për jo më shumë se 4 ditë me radhë;
 - ii) "kufizim në kufij të përcaktuar", për jo më shumë se 10 ditë;
 - iii) "mbajtje page" në masën jo më shumë se 1/2 e pagës mujore për 2 muaj;
 - iv) "gjobitje në pagë" jo më shumë se 1/20 e pagës për 2 muaj;
- b) ndaj studentëve ushtarakë dhe ushtarëve profesionistë e ushtarëve aktivë:
 - i) masat e parashikuara në paragrafët "i" dhe "ii" të shkronjës "a" të këtij neni;
 - ii) "ulje në gradë" një nivel më poshtë vetëm për ushtarët profesionistë e aktivë;
 - iii) "detyra shtesë" jo më shumë se 4 fundjava, vetëm për studentët ushtarakë, ushtarët profesionistë e aktivë;
 - iv) "detyra shtesë", duke përfshirë punë të rëndë ose detyra të tjera, për jo më shumë se 4 ditë me radhë.

Neni 20

Masat disiplinore që jepen nga ushtaraku me gradë kapiten ose toger, si dhe ekuivalentët në Forcat Detare

Ushtaraku me gradën kapiten ose toger, si dhe ekuivalentët në Forcat Detare, për shkeljet që përcaktohen në këtë ligj, jep për ushtarakët e varësisë së drejtpërdrejtë këto masa:

- a) ndaj oficerëve dhe nënoficerëve:
 - i) "ndalim disiplinor", për jo më shumë se 2 ditë me radhë;
 - ii) "mbajtje page" në masën jo më shumë se 1/2 e pagës mujore për 2 muaj;
 - iii) "gjobitje në pagë" jo më shumë se 1/25 e pagës për 2 muaj;
- b) ndaj studentëve ushtarakë dhe ushtarëve profesionistë e aktivë:
 - i) masat e parashikuara në paragrafët "i" dhe "ii" të shkronjës "a" të këtij neni;
 - ii) "detyra shtesë" jo më shumë se 2 fundjava, vetëm për studentët ushtarakë, ushtarët profesionistë e aktivë;
 - iii) "detyra shtesë", duke përfshirë punë të rëndë ose detyra të tjera, për jo më shumë se 2 ditë me radhë.

Neni 21

Kufizime

1. Nëse masa e vënë përfshin njëkohësisht kufizim në kufij të përcaktuar edhe detyra shtesë, këto masa disiplinore kryhen bashkë.

2. Komandanti mund të pezullojë ndëshkimet, pjesët e pakryera të ndëshkimeve ose ta ulë shkallën e ndëshkimit që ka dhënë. Ndëshkimet që janë kryer ose pjesë të kryera të ndëshkimit nuk mund që më vonë të ulen ose të shfuqizohen.

3. Ushtaraku nuk ndëshkohet më shumë se një herë për të njëjtën shkelje disiplinore.

4. Asnjë zyrtar në Ministrinë e Mbrojtjes ose në komandat e forcave nuk mund të caktojë nivele të ndryshme ndëshkimi për shkelje të njëjta. Çdo komandant i autorizuar për të dhënë

ndëshkime, sipas dispozitave të këtij ligji, vendos për ndëshkimin përkatës, në bazë të natyrës së shkeljes, të gradës, moshës, përvojës dhe të vetëdijes së autorit për kryerjen e shkeljes disiplinore.

5. Nëse është dhënë ndëshkimi, ky nuk mund të rritet gjatë shqyrtimit të ankimit.

6. Nuk mund të jepet masë disiplinore për një shkelje të parashikuar nga legjislacioni penal si vepër penale ose kundërvajtje penale.

KREU IV SHKELJET DISIPLINORE

Neni 22 Përkrahja e paligjshme

Ushtaraku, i cili ka dijeni për kryerjen e një shkeljeje të dënueshme nga ky ligj dhe përkrah ose ndihmon shkelësin, duke penguar ose parandaluar kapjen, gjykimin ose dënimin e personit që ka bërë shkeljen, ndëshkohet sipas urdhrit të komandantit, brenda kufijve të përcaktuar në kreun III të këtij ligji.

Neni 23 Bashkëpunimi

Ushtaraku, që bashkëpunon me një ose disa persona të tjerë për të kryer një shkelje që parashikohet në këtë ligj, ndëshkohet sipas urdhrit të komandantit, brenda kufijve të përcaktuar në kreun III të këtij ligji.

Neni 24 Keqpërdorimi i uniformës

Ushtaraku, i cili mban në mënyrë të parregullt, ndryshon ose keqpërdor uniformën ushtarake, ndëshkohet sipas urdhrit të komandantit, brenda kufijve të përcaktuar në kreun III të këtij ligji.

Neni 25 Largimi pa leje në kohë paqeje

Ushtaraku, i cili largohet dhe mungon pa leje nga njësia, reparti ose vendi i shërbimit për një kohë jo më shumë se 5 ditë, ndëshkohet sipas urdhrit të komandantit, brenda kufijve të përcaktuar në kreun III të këtij ligji.

Neni 26 Mungesa pa leje

Ushtaraku, i cili pa leje, për një kohë jo më tepër se 5 ditë, nuk paraqitet në vendin e shërbimit në kohën e duhur ose mungon nga njësia, reparti a vendi i shërbimit, ku është i detyruar të paraqitet në kohën e duhur, ndëshkohet sipas urdhrit të komandantit, brenda kufijve të përcaktuar në kreun III të këtij ligji.

Neni 27 Lëvizja e gabuar

Lëvizja e gabuar nga pakujdesia e teknikës, mjetit, anijes ose aeroplanit nga ushtaraku, kur nuk përbën vepër penale të parashikuar nga Kodi Penal Ushtarak, ndëshkohet sipas urdhrit të komandantit, brenda kufijve të përcaktuar në kreun III të këtij ligji.

Neni 28

Rezistenca ndaj procedimit disiplinor dhe masave disiplinore

Ushtaraku, që nuk pranon procedimin disiplinor ose refuzon kryerjen e masës disiplinore, ndëshkohet me një masë disiplinore më të rëndë, sipas urdhrit të komandantit, brenda kufijve të përcaktuar në kreun III të këtij ligji.

Neni 29

Deklarime zyrtare të pavërteta

Ushtaraku, i cili bën deklarime zyrtare që rezultojnë se janë të pavërteta, kur nuk përbën vepër penale, ndëshkohet sipas urdhrit të komandantit, brenda kufijve të përcaktuar në kreun III të këtij ligji.

Neni 30

Përdorimi i lëndëve narkotike

Ushtaraku, i cili përdor lëndët narkotike: opium, heroinë, kokainë, amfetaminë, acid dietilamid lisergjik (LSD), metamfetaminë, fenciklidinë, acid barbiturik, marijuanë, si dhe përbërës ose derivate të ndonjërit prej këtyre substancave, në njësi ose reparte ushtarake, institucione shtetërore, anije, automjete ose aeroplanë, që janë në përdorim ose nën kontrollin e Forcave të Armatosura, kur nuk përbën vepër penale, ndëshkohet sipas urdhrit të komandantit, brenda kufijve të përcaktuar në kreun III të këtij ligji.

Neni 31

Përdorimi i pijeve alkoolike gjatë detyrës

Ushtaraku, i cili përdor pije alkoolike gjatë kryerjes së detyrës, ndëshkohet sipas urdhrit të komandantit, brenda kufijve të përcaktuar në kreun III të këtij ligji.

Neni 32

Prishja e qetësisë

Ushtaraku, i cili shkakton ose merr pjesë në prishjen e qetësisë në njësi ose reparte ushtarake, kur nuk përbën vepër penale, ndëshkohet sipas urdhrit të komandantit, brenda kufijve të përcaktuar në kreun III të këtij ligji.

Neni 33

Dëmtimi fizik

Ushtaraku, i cili nga pakujdesia i shkakton dëmtime fizike një ushtaraku tjetër, por pa pasoja për shëndetin dhe kur nuk përbën vepër penale, ndëshkohet sipas urdhrit të komandantit, brenda kufijve të përcaktuar në kreun III të këtij ligji.

Neni 34

Dëmtimi i pronës

Ushtaraku, i cili nga pakujdesia shkatërron ose dëmton pronën, pa shkakuar pasoja të rënda materiale, kur nuk përbën vepër penale, ndëshkohet sipas urdhrit të komandantit, brenda kufijve të përcaktuar në kreun III të këtij ligji.

Neni 35

Kërcënime për përfitim

Ushtaraku, i cili kërcënon një person tjetër për të përfituar diçka me vlerë ose për të shlyer një detyrim, për të përfituar favore ose mbrojtje, kur ky veprim nuk përbën vepër penale, ndëshkohet sipas urdhrit të komandantit, brenda kufijve të përcaktuar në kreun III të këtij ligji.

Neni 36

Ushtrimi i dhunës

Ushtaraku, i cili tenton ose ushtron dhunë fizike të paligjshme ndaj një personi tjetër, në rastet kur nuk bëhet kallëzim nga i dëmtuari, ndëshkohet sipas urdhrit të komandantit, brenda kufijve të përcaktuar në kreun III të këtij ligji.

Neni 37

Dëshmia e rreme gjatë procesit disiplinor

Ushtaraku, i cili gjatë procesit disiplinor dëshmon të dhëna të rreme, ndëshkohet sipas urdhrit të komandantit, brenda kufijve të përcaktuar në kreun III të këtij ligji.

Neni 38

Dhënia me dashje e informacionit të gabuar

Ushtaraku, i cili me qëllim jep informacion të gabuar, kur nuk përbën vepër penale, ndëshkohet sipas urdhrit të komandantit, brenda kufijve të përcaktuar në kreun III të këtij ligji.

KREU V

PROCEDURAT

Neni 39

Veprimet procedurale për vendosjen e masave disiplinore

1. Veprimet procedurale për administrimin e masave disiplinore regjistrohen me shkrim. Procedurat e hollësishme disiplinore, mënyra e ruajtjes së dosjeve të masave disiplinore, si dhe mënyra e ekzekutimit të këtyre masave përcaktohen me rregullore të miratuar nga Ministri i Mbrojtjes.

2. Veprimet procedurale për dhënien e masave disiplinore janë si më poshtë:

a) hetimi nga komandanti ose oficeri i caktuar prej tij, për të përcaktuar nëse shkelja është kryer nga ushtaraku;

b) paraqitja me shkrim e shkeljes së ushtarakut të akuzuar dhe shpjegimi i të drejtave. Paraqitja e fakteve të komandantit, për të përcaktuar nëse duhet dhënë masa disiplinore. Nëse e kërkon, ushtaraku mund të këshillohet me një oficer jurist përpara dhënies së masës disiplinore;

c) ushtaraku ka të drejtë të mbrohet vetë ose me përfaqësues të zgjedhur nga ai vetë nga radhët e ushtarakëve të repartit, ku ai është efektiv;

ç) ushtaraku ka të drejtë të njihet me faktet e përdorura nga komandanti, të paraqesë faktet për t'u mbrojtur dhe të paraqesë dëshmitarë;

d) masa disiplinore e dhënë shkruhet dhe i akuzuari informohet për të drejtën që ka, për t'u ankuar te komandanti i një shkalle më të lartë se autoriteti që ka dhënë dënimin. Në dosjen personale të ushtarakut shënohen vetëm masat disiplinore, të mbetura në fuqi pas shterimit të mjeteve të ankimimit;

dh) nëse ushtaraku refuzon të ankimojë masën disiplinore, komandanti që jep dënimin i dërgon një kopje të plotë të procesit disiplinor eprorit të një shkalle më të lartë se autoriteti që ka dhënë dënimin.

KREU VI

ANKIMI

Neni 40

Autoriteti i ankimeve

1. Ushtaraku ka të drejtë të ankohet për masën disiplinore të dhënë tek eprori i një shkalle më të lartë se autoriteti që ka dhënë këtë masë. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm mund t'ia delegojë Zëvendësshefit të Shtabit të Përgjithshëm detyrën për rishikimin dhe marrjen e vendimit për ankimin.

2. Ushtaraku nuk ndëshkohet për dorëzimin e një ankimi.

Neni 41

Rishikimi i procesit

1. Kur ushtarakë të Forcave të Armatosura refuzojnë ankimin e masës disiplinore, eprori i një shkalle më të lartë se autoriteti që ka dhënë masën disiplinore është i detyruar ta rishikojë procedurën disiplinore.

2. Eprori në asnjë rast nuk mund ta rëndojë masën disiplinore të dhënë.

Neni 42

Forma e ankimit

Ankimi bëhet me shkrim, ku jepet arsyeja për ankimin dhe paraqiten fakte, që i proceduari mendon se autoriteti i shqyrtimit të ankimit duhet t'i marrë parasysh.

Neni 43

Afati për ankimin

Ushtaraku ia dorëzon ankimin me shkrim komandantit, që vendos masën disiplinore, brenda 3 ditëve nga shpallja e saj.

Neni 44

Përgjegjësitë e komandantit

1. Komandanti që jep masën disiplinore shqyrton dhe vendos për ankimin brenda 3 ditëve nga marrja e saj. Komandanti vlerëson me kujdes çështjet për lehtësimin dhe zbutjen e masës disiplinore, të paraqitura në ankim dhe pas kësaj mund ta lërë në fuqi, ta ulë, ta pezullojë ose ta shfuqizojë masën disiplinore, por asnjëherë ta rrisë atë.

2. Kur komandanti që jep masën disiplinore refuzon ta ulë, ta pezullojë ose ta shfuqizojë masën disiplinore, ai ia dërgon ankimin, bashkë me të gjithë formularët dhe dokumentet e procesit, komandantit të një shkalle më të lartë, siç përcaktohet në nenin 46 të këtij ligji.

Neni 45

Përgjegjësitë e autoritetit që shqyrton ankimin

1. Brenda 5 ditëve nga marrja e ankimit, shqyrtuesi saj, sipas hierarkisë komanduese, shqyrton të gjitha materialet dhe vendos për ankimin.

2. Me dhënien e urdhrat autoriteti që shqyrton ankimin përcakton nëse komandanti që ka dhënë masën disiplinore e ka bërë këtë në përputhje me të gjitha ligjet, urdhrat dhe rregulloret.

3. Autoriteti që shqyrton ankimin mund:

- a) të hedhë poshtë ankimin e të akuzuarit dhe ta deklarojë masën disiplinore të vlefshme;
- b) të ulë, të pezullojë ose të shfuqizojë masën disiplinore.

4. Autoriteti i shqyrtimit të ankimit e merr vendimin me shkrim.

5. Pas përfundimit të procesit të shqyrtimit të ankimit, dokumentacioni i procedimit disiplinor i kthehet përsëri komandantit që jep ndëshkimin, i cili njofton të proceduarin për vendimin. Autoriteti i shqyrtimit të ankimit i dërgon një kopje të procedimit dhe të vendimit Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

Neni 46

Rishikimi përfundimtar i ankimeve

1. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm bën rishikimin përfundimtar të ankimeve kundër masave disiplinore të dhëna ndaj anëtarëve të Forcave të Armatosura.
2. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm nxjerr urdhër, i cili:
 - a) deklaron që proceset disiplinore janë në përputhje me ligjet, urdhrat dhe rregulloret në fuqi dhe se masa disiplinore është e vlefshme;
 - b) deklaron që proceset disiplinore nuk janë në përputhje me ligjet, urdhrat dhe rregulloret në fuqi dhe urdhëron prapësimin e proceseve dhe shfuqizimin e masës disiplinore;
 - c) ul masën disiplinore.
3. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm nuk mund t'i rrisë ndëshkimet e dhëna nga komandantët.
4. Urdhri i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm është përfundimtar në çështjet e ankimeve.

Neni 47

Llogaritja e afateve

Afatet llogariten në orë dhe në ditë. Afati i ankimit përfundon në orën 24 të ditës së fundit. Kur mbarimi i afatit bie në një ditë pushimi, si dita e fundit e tij llogaritet dita e punës që vjen pas asaj të pushimit.

Neni 48

Rivendosja në afat

Me kërkesën e ushtarakut të interesuar afati, që humbet për arsye të përligjura, rivendoset me urdhër të eprorit, për masat disiplinore që jep ai dhe të komisionit disiplinor, për masat disiplinore që jep ky i fundit.

Neni 49

Ekzekutimi i masave disiplinore

Masa disiplinore vihet në ekzekutim menjëherë pas rishikimit të vendimit të masës disiplinore nga eprori i një shkalle më të lartë se autoriteti që e ka dhënë atë.

Neni 50

Publikimi i masave disiplinore

Masat disiplinore mund të publikohen brenda garnizonit të njësisë ose të repartit ku është kryer shkelja disiplinore. Publikimi në organet e shtypit është i ndaluar.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 51
Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të nxjerrë rregulloret përkatëse, në zbatim të neneve 8 pika 3 dhe 39 pika 1 të këtij ligji.

Neni 52
Shfuqizime

Kreu VI i ligjit nr.7978, datë 26.7.1995 "Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" dhe Rregullorja e Disiplinës së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë shfuqizohen.

Neni 53
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4160, datë 2.3.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

Së shpejti në botim, përmbledhje në fushën e taksave dhe tatimeve

Doli nga shtypi më 12.3.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë